



Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar

Albanian National Olympic Committee

Rr. "Muhamet Gjollësia", Sheshi Mustafa Q. Atatürk, ish 21 Dhjetori, Tiranë / P.O. Box 63
Tel: +355 4 2235 249 • E-mail: secretariat@nocalbania.org.al • <http://www.nocalbania.org.al>

NJOFTIM PËR POZICION VAKANT

“Specialist Mediash Audio-Vizive/ Specialist Prokurimesh”

Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH) është një organizatë sportive Kombëtare e pavarur, themeluar në vitin 1958, pa qëllim fitimi, e organizuar mbi bazën e parimeve të Kartës Olimpikë, dhe që funksionon sipas statutit të saj. KOKSH është organizata e vetme që përfaqëson Lëvizjen Olimpikë Shqiptare, parimet e së cilës janë të detyrueshme për tu zbatuar nga të gjithë anëtarët e saj.

Në kuadër të Projektit “Ekipet Sportive 2022”, projekt i financuar nga Buxheti i Shtetit, KOKSH, fton kandidatët e interesuar për të aplikuar për pozicionin e punës **“Specialist Mediash Audio-Vizive/ Specialist Prokurimesh”**

Objektivi i përgjithshëm i Projektit është krijimi i një Programi Kombëtar që nxit 1) sportin masiv, 2) zbulimin e talenteve, 3) edukatën sportive dhe parimet olimpikë. Projekti do të formojë Ekipet sportive jashtë shkollore në nivelin 9-vjecar (nga klasa e 6 – 9); në nivelin shkollë e mesme (nga klasa 10 – 12); në universitete.

Detyrat e Specialist Mediash Audio-Vizive / Specialist Prokurimesh

Kërkohet një Specialist Mediash Audio-Vizive / Specialist Prokurimesh i/e aftë për të hartuar terma reference teknike për paketë/konsulencë komunikimi të projektit. Specialisti do të përfshihet në procesin e hartimit të termave të referencës dhe në përcaktimin e specifikimeve teknike të nevojshme për uniformat e projektit “Ekipet Sportive 2022”.

Kualifikimet dhe Eksperienca:

- Të ketë përfunduar arsimin e lartë;
- Të paktën 3 vite eksperiencë profesionale në fushën e komunikimit dhe medias.



Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar

Albanian National Olympic Committee

Rr. "Muhamet Gjollësia", Sheshi Mustafa Q. Atatürk, ish 21 Dhjetori, Tiranë / P.O. Box 63
Tel: +355 4 2235 249 • E-mail: secretariat@nocalbania.org.al • <http://www.nocalbania.org.al>

- Preferohet të ketë eksperiencë të mëparshme në hartimin e termave të referencës;
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës Angleze.

Aftësi dhe kompetenca kryesore

- Të ketë aftësi shumë të mira koordinuese, organizative dhe komunikuese;
- Të ketë aftësi shumë të mira në shkrimin e specifikimeve teknike në përgjithësi;
- Të zotrojnë në nivel shumë të mirë "Paketën Office";
- Aftësi bashkëpunuese në grup.

Procedura e aplikimit

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentat e aplikimit si më poshtë:

- Curriculum vitae (CV) në formatin Europass;
- Letër Interesi;
- Fotokopje të diplomave universitare;
- Dokumente të tjera mbështetëse (çertifikata të fituara nga trajnime, pjesëmarrje në konferenca, botime, letra reference, etj).

Kandidatët e interesuar duhet t'i dërgojnë dokumentet e aplikimit deri më datë 8 Qershor 2022, ora 16.00, në adresën secretary.general@nocalbania.org.al, me subjekt: **Aplikim për pozicionin Specialist Mediash Audio-Vizive/ Specialist Prokurimesh**.